



Pranuar / Dorezuar Prilijeho/Prodato Received/Delivery	17 - 11	2023	3 viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	7020/2023		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1272/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1272/2023 të datës 11.10.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë rrugë \_\_\_\_\_, në Komunë të Klllokotit, kundër organit të Punësimit-Komuna e Klllokotit në lidhje me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" Nr.prot.754/2 të datës 03.10.2023 të shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi, Çështje Sociale, Kulturë ,Rini e Sport, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 17.11.2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Apropohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1272/2023 e datës 11.10.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_.
- II. Anulohet masa disiplinore "Vërejtje me Shkrim"Nr.prot.754/2 e datës 03.10.2023 shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi, Çështje Sociale, Kulturë ,Rini e Sport të Komunës së Klllokotit.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klllokotit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjnë zbatimin e këtij vendimi duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit, duke e liguar të njëjtën nga dosja personale në pajtim me këtë vendim.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi, Shërbime Sociale, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Klllokotit më datë 03.10.2023 ka shqiptuar masë disiplinore "Vërejtje me shkrim" me arsyetimin se nuk ka respektuar orarin e punës.

Ankuesi kundër kësaj mase disiplinore më datë 11.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.1272/2023 me numër protokolli 6486/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.10.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Komuna e Klllokotit. Ndërsa Këshilli më datë 19.10.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova:Ankesën me numër protokolli 1272/2023 e datës 11.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtje me Shkrim nga Drejtori i Drejtorisë e datës 03.10.2023 me numër prot. 754/2; Raporti mjekësor nga medical&laboratory "Olive" e datës 28.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 18.10.2023; Akt Emërimit e datës 16.09.2020 të ankuesit; Formulari i vlerësimit në punë për vitin 2021; Formulari i vlerësimit në punë për vitin 2022; Përshkrimi i detyrave të punës për ankuesin; Procesverbali lidhur me bisedën e zhvilluar me nr.prot: 497 e datës 20.07.2022; Ankesën me numër protokolli 1308/3 e datës 09.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Komunën e Klllokotit; Përgjigjeje në procesverbalin lidhur me bisedën e zhvilluar me nr.prot: 935/06 e datës 25.07.2022; Lista e vijueshmërisë në punë e datës 28.09.2023; Emaili i datës 25.10.2023 nga Menaxheri i Personelit në Komunën e Klllokotit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në tekstin në vijim-Kolegji i këshillit)nga shkresat e lëndës konstaton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 16.09.2020 me nr.prot.985/1,mbanë pozitën Zyrtarë i Shëndetësisë në kuadër të Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi, Shërbime Sociale, Kulturë, Rini e Sport në kuadër të Komunës së Klllokotit.

Ankuesi në ankesën me numër prot. 754/2 të datës 03.10.2023 parashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër "Vërejtjes me Shkrim" të shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi, Shërbime Sociale, Kulturë, Rini e Sport në Komunën e Klllokotit e pretendon se përmes shqiptimit të masës disiplinore janë shkelë dispozitat e Ligjit që rregullon përmbajtjen e aktit administrativë, është konstatuar gabimisht gjendja faktike, më është shqiptuar kjo masë disiplinore nga zyrtari jo kompetentë dhe poashtu nuk më është lejuar e drejta e ankesës që është në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit, nisur nga baza ligjore e përcaktuar me dispozitat e Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se kompetenca për shqiptimin e një mase disiplinore e cila është objekt i kësaj ankesë është e paraparë me nenin 48 paragrafi 1, si rrjedhojë paragrafi 1 i nenit 48 të këtij ligji, ka përcaktuar se: "*Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë*", mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, thekson faktin se dispozitat e Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i ka dhënë kompetencë mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil që në rastet kur vlerësohet se nëpunësi civil ka bërë shkelje disiplinore, të ndërmarr veprimet çoftë për shqiptimin e masës së lehtë disiplinore si në nenin 48 paragrafi 1 apo inicimit të procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor për shkelje të detyrimeve nga nëpunësi civil siq parashihet në nenin 48 paragrafi 2 i këtij i ligji i cili parasheh: "*1.Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil*", si rrjedhojë nga shkresat e lëndës përkatësisht me shkresa/emaili i datës 25.10.2023 të dërguar nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Komunës së Klllokotit konfirmohet fakti se ankuesi mbikëqyrës të drejtpërdrejtë ka Udhëheqësin e Sektorit të Shëndetësisë S.M në kuadër të drejtorisë përkatëse ku është i angazhuar ankuesi sipas akt emërimit dhe se kjo pozitë përkatësisht ankuesi i raporton Udhëheqësit të Sektorit për Shëndetësi në Komunën e Klllokotit.

Ndërsa në kuptim të kompetencës për shqiptimin e masave disiplinore dhe inicimin e procedurës disiplinore ,Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: "*1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil*", ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka përcaktuar se: "*1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë*", rrjedhimisht sipas provave të lëndës dhe referuar bazës ligjore si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi, Shërbime Sociale, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Klllokotit nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit dhe mbi këtë bazë nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejtje me Shkrim".

Kolegji i Këshillit, nga konstatimet si më lartë, thekson faktin se masa disiplinore "Vërejtje me shkrim" e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi, Shërbime Sociale, Kulturë, Rini e Sport në Komunën e Klllokotit e datës 03.10.2023 me numër prot. 754/2, përveq që si akt

administrativë nuk është në harmoni me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nga se nuk përmban elementet e domosdoshme si parashihet në nenin 47 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, është nxjerrë në kundërshtim edhe me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 ndërlidhur me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, kështu që për shkak të konstatimit nga ana e kolegjit të këshillit të këtyre shkeljeve procedurale të pasqyruara si më lartë rrjedhimisht duke vërtetuar jo kompetencën e drejtorit të drejtorisë për shqiptimin e kësaj mase disiplinore që është objekt i kësaj ankese nuk u lëshua në konstatimet lidhur me shkeljet e supozuara nga ana e ankuesit, ndërsa ky vendim nuk nënkupton se arsyetohen veprimet e ankuesit por se duhet vetëm të respektohen procedurat që parashihen në legjislacionin aktual nga organet kompetente.

Si u tha më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klllokotit janë të obliguar që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit duke e larguar të njëjtën nga dosja personale e ankuesit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1272/2023, datë 17/11/2023

**Rushit KAJTAZI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Klllokotit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klllokotit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.